



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Primitur / Prizetuar Received / Delivered	22. 09 2023	viti god year	3
Organ / Rjeshtja Org./Unit	Nr. Prot Pr. No	Shtojtja Prilog Appendix	Sasia Koliciteta Quantity
Shqyrtimi	6197/2023		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.806/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-Kryetar, Jeton Koca dhe Ardit Haxhnikaj Demi-anëtarë me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, në bazë të Aktgjykimit A.nr.2786/2021 të datës 30.06.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.806/2021 të datës 15.09.2021 të parashtruar nga ankuesja [redacted] të cilën me autorizim e përfaqëson avoket [redacted] me adresë rruga [redacted].

Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit/Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani", në çështjen juridike "Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur më datë 21.09.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *shpallet jo kompetent* për të vendosur lidhur më ankesën A.nr.806/2021 të datës 15.09.2023 të parashtruar nga ankuesja [redacted].

II. Lënda i dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent/Komisionit të Ankesave për nëpunësit e shërbimit publik në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani".

A r s y e t i m

Ankuesja [redacted] e punësuar sipas Akt Emërimit me numër nr.58 të datës 24.02.2012 në pozitën e punës "Bibliotekare" në Bibliotekën Kombëtarë të Kosovës "Pjetër Bogdani", më datë 15.09.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 4654/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për kompensimin e [redacted].

shpenzimeve për ushqim gjatë punës shujtën ditore nga dy (2) euro në ditë pune, duke filluar nga data 01.01.2015 deri me datën 31.12.2018.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 20.09.2021 me numër protokollit 4704/2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Biblioteka Kombëtare e Kosovës, ndërsa Këshilli më datë 04.10.2021 me numër protokollit 4872/2021 ka pranuar përgjigje në ankesë nga e njëjta me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli në mungesë të kuorumit për vendosje, më datë 01.01.2021 me numër protokollit 5224/2021 ka njoftuar ankuesen lidhur me arsyet e mos shqyrtimit të ankesës dhe ka udhëzuar të njëjtën që t'i ndjek procedurat e mëtejme në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ. Ankuesja, në mungesë të kuorumit për vendosje ka ndjekur procedurat gjyqësore dhe si rrjedhojë ka hapur konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative me datën 30.06.2022 ka nxjerr Aktgjykimin me numër A.nr.2786/2021, i njëjti në Këshill është pranuar me datë 07.04.2023 sipas të cilit ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses dhe ka anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 01.01.2021, duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën A.nr.806/2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 4645/2021 të datës 15.09.2021 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative me numër A.nr.2786/2021 i datës 30.06.2022 i njëjti në Këshill është pranuar me datë 07.04.2023 me numër protokollit 3419/2023; Fletëkthesë e datës 04.11.2021; Njoftim me numër protokollit 5224/2021 i datës 01.11.2021; Autorizim nga Z.K. për avokat A.L. i datës 31.05.2021; Vërtetim nga Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani" për Z.K. me numër nr.60 i datës 31.05.2021; Kërkesa e ankueses tek organi i punësimit i datës 17.06.2021; E-mail nga A.L. për biblioteka@biblioteka-ks.org i datës 17.06.2021; Kërkesa e ankueses tek organi i punësimit i datës 19.08.2021; E-mail nga A.L. për biblioteka@biblioteka-ks.org i datës 19.08.2021; Përgjigje nga organi i punësimit me numër nr.102 i datës 06.09.2021; E-mail nga A.L. për ankesa.kpmschck@rks-gov.net i datës 15.09.2021; Fletëkthesë e datës 23.09.2021; Përgjigje në ankesë me numër protokollit 4872/2021 e datës 04.10.2021; Akt Emërim i Z.K. me numër nr. 58 i datës 24.02.2012; Kërkesë për përgjigje në ankesë me numër protokollit 4704/2021 i datës 20.09.2021;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, **nuk është kompetent** për vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesja, sepse:

Lidhur me këtë çështje juridiko-administrative, Kolegji i Këshilli i u referua Ligjit Nr. 04/L-097 për Bibliotekat përkatësisht:

Neni 3 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, ka përcaktuar se: *“Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim: 1.1. Bibliotekat - Institucione kulturore, arsimore dhe informuese që mbledhin, ruajnë, përpunojnë dhe vënë në dispozicion të përdoruesve koleksionet e veta, ofrojnë qasje të lira në informacione në cilat do forma që janë depozituar”*.

Neni 5 paragrafi 2 ka përcaktuar s: *“Sipas funksionit, veprimtarisë dhe varësisë së tyre, bibliotekat publike klasifikohen në këto lloje: 2.1. Biblioteka Kombëtare e Kosovës; 2.2. biblioteka komunale; 2.3. biblioteka universitare; 2.4. biblioteka shkollore; 2.5. bibliotekat e veçanta”*.

Duke marrë parasysh dispozitat e lartcekura, Kolegji i Këshillit konstaton se Biblioteka Kombëtare e Kosovës hyn në kuadër të institucioneve kulturore dhe arsimore, rrjedhimisht lidhur me statusin e marrëdhënies së punës së ankueses, Kolegji i Këshillit i u referua Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, përkatësisht:

Neni 2 paragrafi 2, përcakton se: *“Zyrtarë publikë janë: 2.1. nëpunësi i Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil); 2.2. nëpunësi i Shërbimit Publik; 2.3. nëpunësi i Kabinetit; dhe 2.4. nëpunësi administrativ dhe mbështetës”,* ndërsa paragrafi 4 i këtij neni përcakton se: *“Nëpunës i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike”*.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në këtë, konstaton se meqenëse ankuesja është e punësuar në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës “Pjetër Bogdani”, atëherë sipas dispozitave të lartcekura e njëjta nuk ka statusin e nëpunësit të shërbimit civil por ka statusin e nëpunësit të shërbimit publik, rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, konstaton se sipas nenit 67 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, ka bërë kategorizimin e nëpunësve të shërbimit publik si: *“Nëpunësit e shërbimit kategorizohen në personelin drejtues, në personelin profesional dhe në personelin e brendshëm të shërbimeve të përbashkëta”,* kështu që meqenëse pozita që mban ankuesja është pozitë e nëpunësit të shërbimit publik, rrjedhimisht edhe e drejta e ankimimit për nëpunësit e shërbimit publik është rregulluar me dispozitat e nenit 24 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik, i cili përcakton se: *“Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen sipas këtij ligji të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente”* dhe nenit 74 paragrafit 1 të këtij ligj, i cili përcakton: *“Zyrtari i shërbimit publik mund të ankohet të punëdhënësi kur pretendon se i janë shkelur të drejtat në marrëdhënien e punës”,* ndërsa nëse pala është e pakënaqur me vendimin e organit



të punësimit mund të iniciojë kontest pune në gjykatën kompetente siç parashihet me nenin 74 paragrafin 5 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Andaj, duke ju referuar dispozitave të nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, nuk është kompetent për vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesja, sepse Këshilli shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për praninë në shërbimin civil.


Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.806/2021

Çlirim Zeka


Procesmbajtës

Eshref Shabani


Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankueses avokatit
- Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamentit për Çështje Administrative, Gjyqtarës Liridona Ajeti Kajtazi;
- Drejtorit të Bibliotekës Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani";
- Komisionit të Ankesave për nëpunësit e shërbimit publik në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani";
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani"; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.